



Financuar nga
Bashkimi Evropian


center for
transparency
and freedom of
information

ema
EUROPEAN MOVEMENT ALBANIA

Raport

2025

RAPORTI I MONITORIMIT, KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR (KLGJ), 2024



PUBLIKUES

QENDRA PËR TRANSPARENÇË DHE INFORMIM
TË LIRË (CTFI)

Adresa: Rr. Komuna e Parisit, Pal.2, Sh. 2,
Tirana, Albania

Tel: +355 682088602

E-mail: info@transparence.al

Web: www.transparence.al

VITI I PUBLIKIMIT:

2025

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE” , me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje	05
Qeverisja e buxhetit	06
Kompetencat e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (KPSAB)	07
Raporti me Ministrinë e Drejtësisë në buxhetim	08
Qeverisja e buxhetit në gjykata	09
Organigrama	09
Buxheti	15
Rastet e ndërhyrjes në buxhet	17
Performanca e buxhetit në nivel programi	17
Situata e investimeve në gjykata	20
Risku i buxhetit të KLGJ	24
Shpenzimet nga të ardhurat e krijuara	24
Kosto për njësi, çështje të shqyrtuara	25
Nevojat buxhetore	26
Marrje me qera	27
Prokurimet	27
Auditimi i gjykatave	28
Stoku i çështjeve	29
Treguesit e efektivitetit	31
• Gjykata e Lartë	32
• Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	33

	34
• Gjykata e Posaçme e Apelit	34
• GJKKO	34
• Gjykata Administrative e Apelit	35
• Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë	35
• Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm	35
Adresimi i stokut nga KLGJ, Strategjia Kombëtare për Uljen e Çështjeve të Prapambetura dhe Plani i Veprimit	36
Transparenca	40
Gjetje dhe përfundime	41
Rekomandime	45
Bibliografia	46

Shkurtesat

- KLGJ - Këshilli i Lartë Gjyqësor
- KPK - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
- KPA - Komisioni i Pavarur i Ankesave
- KLGJ - Këshilli i Lartë Gjyqësor
- KLP - Këshilli i Lartë i Prokurorëve
- ILD - Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
- KED - Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
- SPAK - Zyra e Prokurorit të Posaçëm kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
- BKH - Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH)
- GJKKO - Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
- BE - Bashkimi Evropian
- CEPEJ - Këshilli i Evropës për Efikasitetin e Drejtësisë
- ONM - Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM)
- KLD - Këshilli i Lartë i Drejtësisë
- KLSH, SAI - Institucioni i Kontrollit Shtetëror
- FM - Ministria e Financave
- EMP - Ekipi i Menaxhimit të Programit
- GMS - Grupi i Menaxhimit Strategjik
- PBA - Programi Buxhetor Afatmesëm
- QTI - Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë
- VKM - Vendimi i Këshillit të Ministrave
- KPP - Komisioni i Prokurimit Publik
- ALL - Lekë Shqiptare
- ASHPP - Agjencia Shtetërore e Prokurimit të Centralizuar

Hyrje

Këshilli i Lartë Gjyqësor është një strukturë e re kushtetuese dhe u krijua si pjesë e Reformës në Drejtësi votuar në Parlament në vitin 2016. Funksionet e tij përcaktohen përmes Ligjit 115/2016 “Për organizimin e institucioneve të drejtësisë” [1].

Në bazë të nenit 3 të Ligjit nr. 115/2016, përcaktohet përbërja dhe mandati i anëtarëve të KLGJ-së. [2] Ky organ kolegjal përbëhet nga 11 anëtarë që shërbejnë në detyrë me kohë të plotë. Gjashtë nga anëtarët e KLGJ zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë përkatësisht a) dy anëtarë nga radhët e avokatëve; b) dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës; c) si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Një vit më parë ndodhi edhe ndryshimi i përbërjes në një pjesë të tij, ndërsa një kryetar i ri i KLGJ u zgjodh pas një vonese prej gati një vit.

Mbledhja e parë e Këshillit të Lartë Gjyqësor u zhvillua më datë 20.12.2018, me pjesëmarrjen e plotë të 11 anëtarëve të tij [3].

KLGG-ja ka një mandat më të gjerë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), institucioni pararendës i menaxhimit të gjyqësorit. Kompetencat e KLGJ-së përfshijnë pothuajse të gjitha aspektet e administrimit të gjyqësorit si: emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve; i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë sipas ligjit; drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave; informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor; ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

[1] Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (referuar në raport si Ligji për Qeverisjen);

- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (referuar si Ligji për Organizimin);

- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, i ndryshuar (referuar si Ligji për Statusin);

- Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

- Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar si Ligji për Vetting-un);

- Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

[2] Ligji nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” (shfuqizuar nënë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 16.5.2017 dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 12.12.2017, ndryshuar me ligjin nr. 47/2019, datë 18.7.2019)

[3] <https://www.aksedrejttesi.al/dokumenta/1593250407Vendim-Nr.4-dat%C3%AB-20.12.2018-MBI-DEKLARIMIN-E-KRIJIMIT-T%C3%8B-K%C3%8BSHILLIT-T%C3%8B-LART%C3%8B-GJYQ%C3%8BSOR.pdf>

Pas mbylljes së mandatit të KPK, në fund të vitit 2024, KLGJ mori kompetencat për zhvillimin e vetingut për magjistratët që aplikojnë të hyjnë në sistem apo magjistratë që ende nuk e kanë kryer vetingun.

Qeverisja e buxhetit

Në nenin 95 'Buxheti vjetor i Këshillit dhe Gjykatave' të Ligjit nr.115/2016, "Ligji për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" përcaktohet roli i KLGJ në raport me buxhetin e gjyqësorit ku theksohet se: 1. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe sistemi gjyqësor financohen nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme. 2. Buxheti vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sistemit gjyqësor është pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe ndjek të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të tij, të parashikuara në legjislacionin përkatës. 3. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të tij në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave. 4. Këshilli i Lartë Gjyqësor merr pjesë në mbledhjen e Kuvendit ku diskutohet projektbuxheti i sistemit gjyqësor; 5. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mbikëqyrjen e shpenzimeve, shpërndarjen e fondeve dhe mbajtjen e llogarive të sakta, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë[4].

Edhe neni 96 'Zbatimi i buxhetit gjyqësor' të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i kushtohet çështjes së buxhetit të gjyqësorit ku ndër të tjera theksohet:

1. Në zbatim të kompetencave të parashikuara në nenin 95 të këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen detyrat e mëposhtme: a) ndihmon gjykatat në hartimin e projektbuxheteve të tyre vjetore; b) mbledh dhe analizon të dhëna mbi zbatimin e buxhetit dhe të ardhurat e siguruara nga gjykatat; c) mbikëqyr dhe këshillon gjykatat mbi teknikat dhe procedurat e përshtatshme dhe eficiente që lidhen me menaxhimin financiar të tyre; ç) vendos standarde të praktikave më të mira dhe objektiva të performancës, në lidhje me administrimin financiar të gjykatave; d) siguron trajnim për stafin gjyqësor mbi menaxhimin financiar të gjykatave; dh) ndërmerr projekte me synimin për të përmirësuar menaxhimin financiar të gjykatave; e) merr hapa të tjerë për të lehtësuar gjetjen e fondeve të mjaftueshme dhe të vazhdueshme për gjykatat; ë) bashkëpunon dhe kërkon fonde nga agjencitë e tjera vendase dhe ndërkombëtare në lidhje me funksionet e Këshillit.
2. Për të zbatuar detyrat, e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, si pjesë përbërëse dhe funksionale e Këshillit krijohet njësi e administrimit të buxhetit gjyqësor.

[4] Ligji nr.115/2016, "Ligji për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neni 95 Pas mbylljes së mandatit të KPK, në fund të vitit 2024, KLGJ mori kompetencat për zhvillimin e vetingut për magjistratët që aplikojnë të hyjnë në sistem apo magjistratë që ende nuk e kanë kryer vetingun.

3. Njësia e administrimit të buxhetit gjyqësor ka këto kompetenca kryesore: a) studion dhe përcakton nevojat për buxhet të të gjitha hallkave të gjyqësorit në bashkëpunim me sektorët financiarë të gjykatave të të gjitha niveleve; b) përpunon treguesit financiarë që kanë lidhje me kërkesat dhe veprimtarinë e gjykatave; c) kontrollon përdorimin e fondeve që u janë dhënë gjykatave sipas destinacioneve.
4. Lidhur me veprimtarinë e njësisë së administrimit të buxhetit gjyqësor Këshilli ushtron këto kompetenca: a) miraton projektbuxhetin vjetor dhe afatmesëm të propozuar nga njësia për çdo nivel të gjykatave dhe ia dërgon atë për shqyrtim organit kompetent për shqyrtim dhe miratim, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit përkatës; b) auditon dhe monitoron përdorimin e fondeve të akorduara dhe analizon kërkesat e gjykatave për fonde që mund të lindin gjatë vitit buxhetor.
5. Fondet në dispozicion të Këshillit dhe të gjykatave përdoren për këto qëllime: a) për pagat dhe sigurimet shoqërore të anëtarëve dhe personelit të Këshillit, si dhe të gjyqtarëve, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave; b) për plotësimin e nevojave për shpenzimet operative të Këshillit dhe të gjykatave, si dhe për veprimtari të tjera gjyqësore; c) për ndërtimin ose meremetimin e godinave, si dhe për investime të tjera; ç) për mbulimin e shpenzimeve të gjykatave, lidhur me dhënien e ndihmës së detyrueshme juridike në rastet e parashikuara në dispozitat ligjore të veçanta[5].

Ndërkaq në Nenin 61 'Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor', në ligjin nr.47/2019 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së Ministrisë së Drejtësisë" sanksionohet se: ...2. Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare ushtron kompetencat e mëposhtme: ... d) drejton dhe kujdeset për veprimtarinë në administratën e gjykatave; dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe atë të gjykatave; e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor; ë) miraton akte nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me ndikim të përgjithshëm detyrues për të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore, personat privatë dhe organet publike [6].

Kompetencat e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (KPSAB)

KL Gj, ndër katër komisionet e përhershme të parashikuara në nenin 62 të ligjit 115/2016, ka ngritur edhe Komisionin e Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i cili përbëhet nga 3 anëtarë të KL Gj (2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar) njëri prej të cilëve është kryetar dhe dy anëtarë zëvendësues.

[5] Ligji nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neni 96

[6] Ligji nr.47/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së Ministrisë së Drejtësisë", neni 61

Kompetencat e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (KPSAB) burojnë kryesisht nga Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ndër të tjera, KPSAB është përgjegjës për hartimin, miratimin dhe monitorimin e politikave buxhetore dhe financiare për Këshillin dhe sistemin gjyqësor, duke garantuar burimet e nevojshme financiare në kuadër të mbarëvajtjes së funksionalitetit të vetë Këshillit dhe gjykatave në vend.

Kjo kompetencë e Komisionit del në pah sidomos gjatë procesit të planifikimit të projekt-buxhetit afatmesëm (PBA), negocimit e madje në monitorimin e zbatimit të këtij buxheti, me qëllim jo vetëm garantimin e standardeve të menaxhimit financiar por mbi të gjitha për vlerësimin e situatës financiare dhe buxhetore në Këshill dhe në sistemin gjyqësor dhe rialokimin apo shpërndarjen e fondeve për përmbushjen e nevojave të identifikuara. Komisioni i raporton KLGJ problematikat e evidentuara, harton projektvendime, rregullore apo udhëzime të cilat i paraqiten Këshillit për miratim.

Gjatë vitit 2024, Komisioni ka trajtuar 560 kërkesa për mbështetje teknike. Ashtu si përcaktohet edhe në Raportin Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, ndër të tjera Komisioni “ka realizuar digjitalizimin e arkivës për 27 njësi (gjykata dhe ish-gjykata) përfshirë Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, (si Kukës, Vlorë, Sarandë, etj.), si dhe Zyrat e Shërbimit të ish-Gjykatave të Rrethit, Apelit dhe Administrative. Në total, janë digjitalizuar 11,864,468 fletë[7].”

Raporti me Ministrinë e Drejtësisë në buxhetim

Në nenin 71 me titull ‘Marrëdhënia e Këshillit të Lartë Gjyqësor me Ministrinë e Drejtësisë’, në ligjin Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë” rregullohet edhe raporti i KLGJ me ministrinë e Drejtësisë përkatësisht në paragrafet 5,6,7:

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë për të siguruar përputhjen e planeve strategjike dhe buxhetore të sistemit gjyqësor, të miratuara nga Këshilli me politikat shtetërore dhe strategjinë sektoriale të sektorit të drejtësisë.

6. Ministri i Drejtësisë mund të ushtrojë të drejtat e mësipërme personalisht ose përmes një përfaqësuesi të autorizuar me shkrim prej tij.

[7] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 17. <https://klgj.al/media/1bhpv5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

7. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Ministri i Drejtësisë ka akses të plotë në të dhënat statistikore që rezultojnë nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të trajtuara nga gjykatat”[8].

Qeverisja e buxhetit në gjykata

Në nivelin e gjykatave, përgjegjësia e hartimit dhe zbatimit të buxhetit i përket Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për gjykatat e kategorisë së parë dhe Sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për gjykatat e kategorisë së dytë dhe të tretë. Struktura e tyre është përcaktuar edhe përmes një vendimi të KLGJ Nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”.

Sipas këtij vendimi, përkatësisht në nenin 10, Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar është përgjegjës për përgatitjen e projekt buxhetit të gjykatës, monitorimin e shpenzimeve buxhetore, kryerjen e pagesave dhe çdo transaksioni financiar të parashikuar nga buxheti, si dhe për administrimin e vlerave materiale dhe monetare sipas ligjit.

Nëpunësit të këtij sektori kryejnë detyrat e përcaktuara në përshkrimin e punës bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Ata mbikëqyren nga Kancelari, dhe raportojnë periodikisht në Këshillin e Gjykatës, një strukturë kontrolluese dhe vendimmarrëse që përbëhet nga kryetari i gjykatës, nënkryetari i gjykatës dhe kancelari [9].

Organigrama

Numri i punonjësve të Sistemit Gjyqësor i miratuar me ligj për vitin 2024, është 1,759 punonjës, nga këto; 138 punonjës janë punonjës të stafit të KLGJ-së, 6 punonjës i perkasin QTI-së, 1,615 punonjës është organika e stafit gjyqësor.

[8] Ligji Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, neni 71

[9] Vendimi i KLGJ Nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”

Numri faktik për vitin 2024 për sistemin gjyqësor është 1,527 vetë, ose në masën 86.8%. Ndërsa janë 227 vakanca nga të cilat; 33 janë vakancat në KLGJ[10], 1 është në QTI, 198 janë vakancat e përhershme në gjykata.

Numri i punonjësve të KLGJ-së, i miratuar me ligj është 138 punonjës ndërsa në 31 dhjetor 2024, rezultojnë 108 punonjës, pra ka mungesë me 30 punonjës [11]. Struktura organizative e Këshillit të Lartë Gjyqësor, përbëhet nga 138 punonjës nga të cilët 11 janë Anëtarët e Këshillit. Aktualisht, organika faktike e KLGJ-së, është 105 punonjës në total [12].

Numri i punonjësve të miratuar me ligj për QTI është 6 punonjës, ndërsa aktualisht janë 5 punonjës.

Për vitin 2024, numri i punonjësve të miratuar me ligj për gjykatat, (programi 03310 "Buxheti Gjyqësor"), është 1,615 punonjës nga këto; 408 janë magistratë dhe 1,207 janë punonjës të administratës gjyqësore.

Në 31 dhjetor 2024, në gjykata rezultojnë faktikisht 1,417 punonjës nga të cilët 333 magistratë dhe 1084 punonjës administrate. Në total ka mungesa në strukturat organike me 198 punonjës; nga të cilët 75 janë gjyqtarë (vakanca të përhershme) dhe 123 janë punonjës administrate. Ndërkohë nga 333 magistratë në fakt, 61 (vakanca të përkohshme) prej tyre janë të pezulluar me vendim të KPK dhe paguhet me 75% të pagës.

Kategorizimi i gjykatave përmes një vendimi të KLGJ [13] në vitin 2023 ka krijuar një hendek në mënyrat e pagesës dhe trajtimit të administratës jogjyqësore në gjykata.

Gjatë diskutimeve në takimet e organizuara nga QTIL, zyrtarë të gjykatave kanë ngritur këtë problem duke kërkuar edhe trajtimin e tyre [14].

KLGGJ ka ngritur një grup pune për hartimin e rregullave për vlerësimin e kategorive të nëpunësve civilëgjyqësorë, i cili është angazhuar intensivisht, nëpërmjet zhvillimit të takimeve periodike mes anëtarëve të tij ndërsa janë duke u përpiluar aktet përkatëse.

[10] Shënim. Në paragrafin në vijim janë shënuar si vakanca nga KLGJ 30 punonjës dhe jo 33. Në disa raste në raportimet e institucioneve të drejtësisë ka diferenca në shifra për të njëjtën çështje. Një pjesë e tyre kur flitet për punonjës lidhet me faktin se disa vakanca mbushen me punësime të përkohshme, disa të tjera lidhen me mënyrën e llogaritjes si në rastin e kostos për dosje, dhe në disa raste janë gabime gjatë llogaritjeve të ndryshme. Këto shmangie pothuajse nuk tjetërsojnë pamjen për problematikat të ndryshme në gjyqësor.

[11] Raporti i Komisionit të buxhetit, 2024

[12] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 17. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

[13] Vendim i KLGJ nr. 147, datë 29.03.2023, "Për përcaktimin e kategorive të gjykatave"

[14] Forumi civil, Kukës, 23 dhjetor 2024, QTIL, EMA, BE

Veprimtaria e këtij grupi pune pritet të finalizohet në fillim të vitit 2025, duke garantuar në këtë mënyrë kornizën kuadër për normimin e punës së administratës civile gjyqësore, rritjen e integritetit, llogaridhënies dhe profesionalizmit të saj [15]. Ndërkaq, tri gjykata të kategorisë së tretë i kanë dërguar një relacion KLGJ në lidhje me ngritjen e pagave. Relacioni flet për rreth 400 zyrtarë gjyqësorë që kërkojnë ngritje pagash.

Në kuadër të Strategjisë për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura 2024-2027, KLGJ-ja ka propozuar rritjen e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit, nga 13 në 22 gjyqtarë, si dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë nga 408 në 417 gjyqtarë. Sa i përket rritjes së numrit të ndihmësve ligjorë në kuadër të plotësimit të vakancave aktuale, 6 ndihmës ligjorë janë pranuar në shërbimin civil gjyqësor në muajin tetor të vitit 2024 [16]. Ndërsa, për vitin 2025 Këshilli ka nisur procedurën e verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës viti akademik 2024-2025, për 11 (njëmbëdhjetë) ndihmës ligjorë. Në gjykatat e të gjitha niveleve, rezulton se për vitin 2024 janë trajnuar 113 (njëqind e trembëdhjetë) nëpunës civilë gjyqësorë.

Gjatë vitit 2024, kanë ushtruar efektivisht funksionin e gjyqtarit në gjykatat e të gjitha niveleve, gjithsej 272 gjyqtarë në të njëjtën periudhë kohore. Kjo nënkupton se sistemi gjyqësor gjatë vitit 2024 ka funksionuar me pothuajse 66.6% të kapacitetit të tij, 6.6% më shumë se në vitin 2023. Gjatë vitit 2024, janë emëruar 32 magjistratë. Referuar të dhënave statistikore, numri i magjistratëve të emëruar në sistem nga viti 2019 në vitin 2024 është 144 magjistratë, nga të cilët 4 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe 140 magjistratë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Në lidhje me humbjet nga sistemi si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar rezultojnë 113 vendimmarrje shkarkim nga detyra me vendim të formës së prerë nga ana e KPA-së, nga të cilat 24 vendimmarrje i përkasin vitit 2024. Që nga fillimi i procesit të rivlerësimit kalimtar me vendim të KPK-së janë shkarkuar nga detyra 144 gjyqtarë, me një efekt financiar në shumën 965,768,125 lekë, deri në 31 dhjetor 2024.

Përgjatë vitit 2024, në total rezultojnë 60 gjyqtarë me vendimmarrje nga KPK-ja për shkarkim nga detyra, të cilët presin zhvillimin e procesit në KPA, duke mbajtur ndërkohë statusin e gjyqtarit për shkak të pezullimit, si dhe duke përfutur njëkohësisht 75% të pagës bruto fillestare, sipas ligjit. Një situatë e tillë përlogaritet me një efekt financiar në shumën 140,992,975 lekë.

Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezulton se numri i vakancave në sistem, për gjyqtarë është 136 vakanca (nga të cilat 75 të përhershme dhe 61 vakanca të përkohshme)[17].

[15] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 27. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

[16] Vendim i KLGJ nr. 592 dhe 593, datë 09.10.2024; nr. 483, datë 31.07.2024; nr. 588, datë 09.10.2024; nr.591, datë 09.10.2024; nr. 282 dhe nr. 283, datë 29.05.2024. nr. 585, datë 09.10.2024.

[17] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 27. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>


Numri i magistratëve (gjqtarëve), gjatë vitit 2024, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

		1 janar 2024	1 janar 2024	1 janar 2024	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2024
Nr.	Gjykata	Struktura organizative	Organika në fakt	Efektivisht në detyrë	Struktura organizative	Organika në fakt	Efektivisht në detyrë
1	Gjykata e Lartë	19	19	18	19	18	17
2	Gjykata e Apelit JP Tiranë	78	34	25	78	31	28
3	Gjykata e Posaçme e Apelit	11	10	10	11	10	10
4	Gjykata JP Berat	8	9	5	8	8	6
5	Gjykata JP Dibër	7	8	7	7	9	7
6	Gjykata JP Durrës	23	14	12	23	14	16
7	Gjykata JP Elbasan	18	16	11	18	18	13

		1 janar 2024	1 janar 2024	1 janar 2024	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2024
Nr.	Gjykata	Struktura organizative	Organika në fakt	Efektivisht në detyrë	Struktura organizative	Organika në fakt	Efektivisht në detyrë
8	Gjykata JP Fier	21	24	14	21	23	17
9	Gjykata JP Gjirokastrë	7	8	4	7	9	4
10	Gjykata JP Korçë	15	16	12	15	18	11
11	Gjykata JP Kukës	7	8	5	7	8	7
12	Gjykata JP Lezhë	11	12	7	11	11	9
13	Gjykata JP Sarandë	7	8	6	7	10	6
14	Gjykata JP Shkodër	15	15	10	15	17	10
15	Gjykata JP Tiranë	80	63	49	80	62	55

		1 janar 2024	1 janar 2024	1 janar 2024	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2024
Nr.	Gjykata	Struktura organizative	Organika në fakt	Efektivisht në detyrë	Struktura organizative	Organika në fakt	Efektivisht në detyrë
16	Gjykata JP Vlorë	16	17	12	16	18	12
17	GJK.K.O	16	9	9	16	11	11
18	Gjykata Apelit Administ rat	13	8	11	13	7	13
19	Gjykata Administ Sh. Parë Lushnjë	9	10	6	9	10	7
20	Gjykata Administ Sh.Parë Tiranë	27	21	14	27	21	17
		408	329	247	4088	333	272

Tab: Varianca e magistratëve përgjatë vitit 2024



Buxheti

KL Gj ka përfituar për vitin 2024 një buxhet në shumën 4,967,459, 000 lekë (afërsisht 50 milionë euro)[18], i ndarë përkatësisht:

Programi 01110, “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në shumën 381,059,000 lekë. Ky buxhet i përket KL Gj si institucion.

Programi 01140, “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë, QTI”, në shumën 16,800,000 lekë.

Programi 03310, “Buxheti Gjyqësor” në shumën 4,569,600,000 lekë [19]. Ky zë buxheti i përket gjykatave të vendit.

Gjatë vitit 2024, buxheti total është pakësuar në shumën 57,739,042 lekë, nga të cilat; buxheti për KL Gj është pakësuar fondi në shumën 21,187,306 lekë; në programin për QTI është shtuar fondi në shumën 100,000 lekë, ndërsa në programin për gjykatat është pakësuar fondi në shumën 36,661,736 lekë [20].

[18] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 33. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

[19] Ligji nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”


[20] KL Gj/ Raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2024

Kërkesat buxhetore për të gjithë sistemin gjyqësor (KLGJ–në, Gjykata dhe QTI) për vitin 2024, ishin programuar në shumën prej 7,331,450 mijë lekë (afro 74 milionë euro), gjatë përgaditjes së PBA2 në shtator të vitit 2023, ndërsa tavanet përfundimtare të miratuara nga Ministria e Financave ishin në shumën prej 3,885,650 mijë lekë (afro 39 milionë euro), pra kërkesat buxhetore për vitin ushtrimor 2024, ishin më të larta se tavanit i miratuar në shumën 3,445,800 mijë lekë, ose në masën 89 % më shumë sesa tavanët e miratuar [21].

Buxheti i rishikuar vjetor për grupin buxhetor si rezultat i ndryshimeve të mësipërme është në shumën 4,909,719,958 lekë. Realizimi vjetor, si grup buxhetor është në shumën 4,734,657,970.2 lekë ose në masën 96%. Nga të cilat: programi 0110 (KLGJ) në masën 90%; programi 0140 (QTI) në masën 76% dhe programi 03310 (Gjykatat) në masën 97%.

Nga tabela më poshtë konstatohet se buxheti për KLGJ ka ardhur në rritje nga viti në vit, kështu buxheti për vitin 2024 është gati dyfishi i buxhetit në vitin 2019.

Vitet	Buxheti për gjyqësorin
2019	3,005,910, 000
2020	3,409,150,000
2021	3,444,200,000
2022	3,759,808,000
2023	4,684,713,846
2024	4,967,459,000
2025	6,159,959,000



Ndërsa në vlerë absolute buxheti i miratuar për vitin 2024 është afërsisht 17.5 euro/banor ndërkohë që mesatarja e vendeve të Europës është 28.3 euro/banor, për vende me PBB më të vogël se 10,000 euro/banor. Kjo do të thotë se pavarësisht rritjes që ka pasur në buxhetin gjyqësor, jemi ende larg mesatares së BE-së [22].

Rastet e ndërhyrjes në buxhet

Gjatë vitit buxhetor 2024, buxheti i sistemit gjyqësor është rishikuar 11 herë, duke u shtuar dhe pakësuar në shumën absolute prej -57,739 mijë lekë [23]. Ndryshimet janë realizuar përmes një komunikimi me ministrinë e Financave dhe miratimin e shkresave nga ana e saj. KLGJ në raportin vjetor të monitorimit nuk ka theksuar vonesa në përgjigjen e ministrisë së Financave ndaj propozimeve të KLGJ për rishikim të shpenzimeve të programeve të ndryshme të buxhetit.

Performancë e buxhetit në nivel programi

[22] European judicial systems - CEPEJ Evaluation Report – 2024 Evaluation cycle (2022 data)

[23] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 33. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

Buxheti i planifikuar për KLGJ si institucion (Buxheti i alokuar me ligjin e buxhetit për programin 01110 - Planifikim, menaxhim dhe administrim të grupit buxhetor “Këshillin e Lartë Gjyqësor”) në fillim të vitit 2024 ishte në shumën 381,059,000 lekë, i detajuar përkatësisht; në shumën 366,059,000 lekë në shpenzime korrente (paga, sigurime dhe shpenzime të tjera) dhe 15,000,000 lekë në shpenzime kapitale të trupëzuara.

Buxheti është rishikuar përmes 7 vendimeve duke u pakësuar me - 21,187,306.00 lekë.

Buxheti i rishikuar vjetor për programin 01110 është në shumën 359,871,694 lekë, nga të cilat; 345,488,694 lekë në shpenzime korrente dhe 14,383,000 lekë në investime.

Realizimi vjetor për këtë program është në shumën 322,949,150.85 lekë ose në masën 90% “Artikulli 600”, ose pagat është realizuar në shumën 226,257,266 lekë ose në masën 98% [24].

“Artikulli 602” buxheti për “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera” për këtë program është në shumën 73,150,000 lekë, ndërsa realizimi faktik është në shumën 48,509,055.85 lekë ose në masën 66%. Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit të KLGJ-së me materiale e shërbime zyre, shpenzime për udhëtim e dieta si dhe janë kryer likuidimet e shpenzimeve të shërbimeve ndaj të tretëve për drita, ujë, energji elektrike, “Shërbim printimi dhe fotokopjimi”, Shpenzime transporti” “Shërbim mirëmbajtje pajisje audio - Sallë plenare”, shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore etj.

Buxheti vjetor për shpenzime kapitale, (Artikulli 231) në këtë program, në fillim të vitit në shumën 15,000,000 lekë, është rishikuar në shumën -617,000 lekë pas prokurimit në një çmim nën shpallje. Buxheti i rishikuar në shpenzime kapitale është 14,383,000 lekë i detajuar në dy produkte, “Pajisje Software” dhe “Blerje mjete motorrike”. Fondi në shumën 14,383,000 lekë është realizuar (tejkualuar në një shifër të vogël) në këtë program në shumën 14,381,390 lekë, ose në masën 100%.

Realizimi i fondeve buxhetore për KLGJ për vitin 2024, është në masën 90%.

Për programin e dytë të menaxhuar nga KLGJ (01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë, QIT”), fondi është në shumën 16,800,000 lekë. Gjatë vitit 2024, buxheti në këtë program është rishikuar një herë duke arritur në shumën 16,900,000 lekë. Realizimi faktik për vitin 2024 është në shumën 12,858,553 lekë ose në masën 76 % kundrejt buxhetit të rishikuar vjetor. Realizimi më i ulët është ai për shpenzime dhe mallra në masën 49% e buxhetit të rishikuar vjetor si dhe fondi “Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë ” në shumën 24,000 lekë, u realizua në masën 1%.

Për programin e tretë dhe kryesor që i dedikohet gjykatave (03310 “Buxheti Gjyqësor”), fondi në fillim të vitit 2024, ishte në shumën 4,569,600,000 lekë, u rishikua si rezultat i shtesave dhe pakësimeve në shumën totale -36,651,736 lekë.

Buxheti i rishikuar vjetor për këtë program, është në shumën 4,532,948,264 lekë; nga të cilat 4,209,331,264 lekë në shpenzime korrente dhe 323,617,000 lekë në shpenzime kapitale.

[24] Paga bruto e kryetarit të KLGJ është 611,847 lekë.

Ulja tek shpenzimet kapitale ka ndodhur për shkak të kursimeve në vlerat e prokurimeve si në artikullin ‘studime, projekte, kërkime’ në GJKKO apo pamundësi alokimi të fondit për shkaqe jashtë gjyqësorit si rasti i gjykatës së Kukësit ku mungonte leja për shesh ndërtimi për rikonstruksion.

Detaje

Artikulli 230-231 (Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm) është pakësuar në shumën totale 45,000,000 lekë, me Aktin Normativ nr 5, datë 19.12.2024, si më poshtë. Janë 6 raste pakësimi mes të cilave edhe ;

Artikulli 230 - “Shpenzime kapitale të patrupëzuara”

- Pakësimin kod projekti M290066 “Studime, Projekte, Kërkime, në shumën 4,650,000 lekë, i cili i referohet tepricës nga prokurimi i fondit të rishpërndarë për GJ.P.K.K.O, (programi 03310).

Artikulli 231- “ Shpenzime kapitale të trupëzuar”

- Pakësuar kod projekti 23AC101 “Blerje mjete motorike”, në shumën 172,000 lekë, (programi 01110).
- Pakësuar kod projekti 23AC201 “Programe për software”, në shumën 445,000 lekë, (programi 01110).
- Pakësuar kod projekti 18AD801 “Blerje pajisje zyre”, në shumën 2,927,900 lekë, i cili i referohet tepricës së prokurimit të fondit nga 5 gjykata, (programi 03310).
- Pakësuar kod projekti 23AC401 “Blerje pajisje elektronike”, në shumën, 3,600,000 lekë në administrim të KLGJ (programi 03310).
- Pakësuar kod projekti M290068 “Ndërtim i ri rikonstruksion i plotë dhe të pjesshëm”, në shumën 33.205.100 lekë, i cili i referohet tepricave nga prokurimi i fondeve në këtë kod projekti i 6 gjykatave si edhe fondi i papërdorur në programin 03310 të KLGJ si dhe fondi i planifikuar në fillim të vitit për Gj.Sh.I.J.P Kukës, e cila për shkak të problemeve lidhur me sheshin e ndërtimit, nuk arriti të realizojë me sukses prokurimin e fondit në rikonstruksion, (programi 03310)[25].

Buxheti i rishikuar vjetor në shpenzime kapitale si grup buxhetor është në shumën 338,000,000 lekë. Realizimi është në shumën 298,302,877.6 lekë, ose në masën 88% të buxhetit të rishikuar vjetor.

Realizimi faktik i buxhetit për gjykata është në shumën 4,398,850,266.35 lekë, ose në masën 97 %, i detajuar në 4,114,928,778.75 lekë, në shpenzime korente ose në masën 98% dhe 283,921,487.60 lekë ose në masën 88 % në shpenzime kapitale.

Realizimi në këtë masë i artikullit 600-601 është i lidhur me rishikimin e buxhetit në këtë zë shpenzimesh si dhe mungesat në sistemin gjyqësor. Për vitin 2024, numri i punonjësve të miratuar me ligj për programin “Buxheti Gjyqësor”, është 1,615 punonjës nga këto; 408 janë magjistratë dhe 1,207 janë punonjës të administratës gjyqësore.

Në fund të muajit dhjetor 2024, në gjykata rezultonin faktikisht 1,417 punonjës nga të cilët 333 magjistratë dhe 1084 punonjës administrate. Në total ka mungesa në strukturat organike me 198 punonjës; nga të cilët 75 janë gjyqtarë (vakanca të përhershme) dhe 123 janë punonjës administrate. Ndërkohë nga 333 magjistratë në fakt, 61 (vakanca të përkohshme) prej tyre janë të pezulluar me vendim të KPK dhe paguhen me 75% të pagës.

Për sa i përket artikullit 602 “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” është realizuar plotësisht objekti i planifikuar i prokurimit në shumën 273,911,390 lekë ose në masën 95%, diferencat janë teprica nga prokurimet online për mirëmbajtjen e ICMIS, regjistrimit audio, furnizimit më internet, mirëmbajtja e programit financiar cloud, blerje licencash dhe mirëmbajtje të faqes online, shërbime të sigurisë fizike dhe kibernetike.

Të gjitha kërkesat e gjykatave për shpenzime apo investime në vitin 2024 janë plotësuar 100% nga ana e KLGJ [26].

Situata e investimeve në gjykata

Në total fondi në shpenzime kapitale për programin 03310 sipas buxhetit të rishikuar vjetor në shumën 338,000,000 lekë, janë realizuar në shumën totale 298,302,877.60 lekë, ose në masën 88%.

Diferenca lidhet me mos likuidimin e vlerës së kontraktuar për disa objekte prokurimi pasi produktet nuk i përmbushnin kriteret e kontraktuara; mungesa e ofertave nga Operatorët Ekonomikë, gjatë procedurës së prokurimit të cilat kanë sjellë anulimin e procedurave; diferencat (teprica) nga prokurimet online të fondit.

Produkti M290068 “Ndërtim ndërtësash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm” është edhe produkti që kërkon vëmendje të shtuar pas hartimit të hartës së re gjyqësore që ka sjellë transformim në ngarkesën e disa gjykatave të kategorisë së parë.

Për vitin 2024 ishin programuar për këtë produkt fondet në shumën 113,900,000 lekë.

Buxheti u rishikua[27] në shumën 84,494.900 lekë me fokus 10 gjykata nga 12 të parashikuara në fillim të vitit. Fondi është realizuar në masën 77%.

Duke qenë se pjesë e kërkesave në dokumentin e PBA-së kanë qenë kërkesat për studime projekte, për ndërtimin e godinave të reja për Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ky fond do të shërbente për hartimin e projektit të godinave të reja për këto gjykata, në rast miratimi të sheshit të ndërtimit dhe do të transferohej në kodin e projektit M290066 "Studime dhe projekte".

Buxheti i rishikuar në këtë kod projekti si rezultat i ndryshimeve të sipërcituara është në shumën 84,494,900 lekë për 10 gjykata si më poshtë:

1. Gjykatës së Lartë, ju akordua fondi në shumën 3,800,000 lekë i cili u rishikua në shumën 3,020,000 lekë është përdorur për kryerjen e punimeve në nivel mirëmbajtje për disa meremetime në ambientet e godinës së kësaj gjykate. Gjykata ka përfunduar plotësisht realizimin e objektit të prokurimit në shumën 2,683.703 lekë, ose në masën 89%.

2.Për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë detajuar fondet në shumën 27,000,000 lekë. Fondi i rishikuar në shumën 26,030,000 lekë ka shërbyer për rikonstruksionin e ambienteve të godinës ekzistuese. Punimet u fokusuan kryesisht për rikonstruksionin e rrjetit elektrik e kompjuterik, i cili rezultonte i amortizuar dhe shpërnda;ja e energjisë elektrike nuk ishte në proporcionin e duhur, pra kishte nevojë urgjente për ndërhyrje. Gjykata ka përfunduar plotësisht realizimin e fondit në 26,009,661 lekë, ose në masën 100%.

3.Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, janë detajuar fonde në shumën 1,700,000 lekë. Objekti i investimit është përshtatja e dhomës së serverit. Fondi nuk u realizua për arsye se procedura e prokurimit është anuluar pasi nuk janë paraqitur oferta.

4.Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ju rishpërnda fondi në shumën 852,000 lekë, me qëllim funksionalizimin e godinës së ish-Gjykatës së Apelit Durrës, për transferimin e dhomës civile. Gjykata ka përfunduar plotësisht realizimin e objektit të prokurimit në shumën 673,227 lekë, ose në masën 79%. Diferenca është tepriçë prokurimi online.

5.Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ju rishpërnda fondi në shumën 15,000,000 lekë, i rishikuar në shumën 14,942,900 lekë është përdorur për vënien në funksionim të sistemit të kondicionimit ngrohje-ftohje. Gjykata ka përfunduar realizimin e fondit në shumën 10,557,847 lekë, ose në masën 710 . Diferenca është tepriçë prokurimi.

6.Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ju rishpërnda fondi në shumën 340,000 lekë, me qëllim përshtatjen e ambienteve të ish- Gjykatës Kurbin për arkivën e kësaj gjykate. Gjykata ka përfunduar plotësisht realizimin e fondit, në shumën 300,000 lekë ose në masën 88%.

[27] Akti Normativ nr. 5, datë 19.12.2024

7.Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, janë detajuar fondet në shumën 2,400,000 lekë me objekt rikonstruksioni i tarracës së godinës. Gjykata ka përfunduar plotësisht realizimin e objektit të prokurimit në shumën 2,299,795 lekë, ose në masën 96%. Diferenca është tepriçë prokurimi.

8.Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar janë rishpërndarë fondet në shumën 10,200,000 lekë për blerjen e 3 ashensorëve të rinj për godinën, ku ushtrojnë aktivitetin Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjykata ka përfunduar plotësisht realizimin e fondit 10,022,400 lekë, ose në masën 99%.

9.Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, janë detajuar në fillim të vitit fondet në shumën 13,000,000 lekë, rishikuar në shumën 12,310,000 lekë me objekt përshtatja e dhomës së serverit në zbatim dhe në përputhje me “Standardet për ndërtimin e dhomës së serverit në gjykata”. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit por nuk është bërë likuidimi i situacionit të punimeve për arsye të mosplotësimit të standardeve të punimeve.

10.Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, janë detajuar fonde në shumën 16,500,000 lekë. Objekti i investimit ishte rikonstruksioni dhe përshtatja e ambienteve të ndërtesës së ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë. Gjykata e re është akomoduar në këtë ndërtesë dhe ka marrë gjithashtu edhe katin e tretë të saj, që përdorej më parë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Gjykata ka përfunduar realizimin e objektit të prokurimit dhe realizuar fondin në shumën 12,543,471.6 lekë, ose në masën 98%.

Projekti M290068 “Ndërtime ndërtesash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesëshëm” në shumën 84,494,900 lekë është realizuar në shumën 65,090,105 lekë, ose në masën 77% pasi nuk u përfunduan procedurat e prokurimit nga ana Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat.

Për vitin buxhetor 2024 u detajuan fonde në Artikullin 230 “Investime/aktive afatgjata jo materiale”, kodi i projektit M290066 “Studime, Projektme, Kërkime”, në shumën 28,000,000 lekë, në administrim të KLGJ me qëllim financimin e hartimit të projektit të zbatimit për ndërtimin e godinës së re për Gjykatën e Lartë[28]. Gjatë vitit duke qenë se nuk ka pasur zhvillime të reja lidhur me lejet për sheshet e ndërtimeve dhe nisur nga nevoja të lindura rishtazi, fondi në këtë kod projekt është rishikuar, në shumën 25,800.000 lekë.

Gjatë vitit GJKKO ka përcjellë në KLGJ, kërkesën për hartimin e projektit të zbatimit, të sistemit elektronik të ndërtesës për instalimin e një sistemi të ri ngrohje-ftohje-ventilim (BMS dhe VRF), përfundimi i të cilëve i hap rrugë realizimit të tyre gjatë vitit 2025, në shumën 6,850,000 lekë [29].

[27] Akti Normativ nr. 5, datë 19.12.2024

[28] Vendim i KLGJ nr. 743, datë 28.12.2023 “Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për sistemin gjyqësor”

[29] Raporti i monitorimit të buxhetit të KLGJ për periudhën janar-dhjetor 2024

Projekti 21AC501 “Programe Software për gjykatat”, janë detajuar fonde buxhetore në shumën 116,100,000 lekë [30] si më poshtë:

-Projekti për digjitalizimin e dosjeve të arkivit gjyqësor, janë detajuar për vitin 2024, fondet në shumën 38,600,000 lekë. Ky projekt ka filluar të zbatohet që në vitin 2022 dhe ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023. Gjatë vitit 2024 është realizuar ky projekt në shumën 31,010,166 lekë, ose në masën 80%. Diferenca ka të bëjë me mos likuidimin e një zëri të kontratës pasi raportet e mirëmbajtjes për gjashtëmujorin e fundit të vitit 2024 nuk u konsideruan të vlefshme nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së detyrimeve kontraktore.

-Disaster Recovery, janë detajuar në shumën 1,428,000 lekë. Sistemi Disaster Recovery, është vënë në funksionim në korrik 2022 në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Në rast fatkeqësish, sistemet sigurojnë institucionin që proceset e tij kritike, të vazhdojnë funksionimin e tyre pa u ndërprerë, duke u ndjekur nga një fazë tjetër rikuperimi, e cila synon kthimin e proceseve në një gjendje normale. Gjatë vitit 2024 është realizuar ky projekt në shumën 1,427,749 lekë, ose në masën 100%.

-Infrastruktura mbështetëse ICMIS i ri janë detajuar në shumën 4,200,000 lekë. Që gjatë vitit 2022 është implementuar faza e parë infrastrukturës mbështetëse për hostimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve (ICMIS).

Kërkesat teknike për krijimin e infrastrukturës mbështetëse për hostimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve (ICMIS) janë miratuar me vendimin nr. 7, datë 26.07.2022, të Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë. Gjatë vitit 2024 është realizuar ky projekt në shumën 4,200,000 lekë, ose në masën 100%.

Për vitin 2025, përfshihen fondet për projektin e ri të sistemit ICMIS si dhe marrëveshjen e grantit midis Suedisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, marrëveshje që u bllokua për shkak të ngrirjes së fondeve për këtë qëllim në 2023 nga Ministria e Financave. Projekti ICMIS përfshin 5 vite buxhetore. Kësti i parë i grantit të qeverisë suedeze u disbursua në dhjetor 2024, duke shënuar fillimin e punës për ngritjen e sistemit të ri dhe nisjen e zbatimit të tij në janar 2025 [31].

-Regjistri OJF, janë detajuar në shumën 4,800,000 lekë. Ky projekt ka filluar që në vitin 2022. Fondet buxhetore për këtë projekt nevojiten për implementimin e licencave të cilat ndihmojnë infrastrukturën dhe garantojnë vazhdimësinë e procesit të punës. Gjatë vitit 2024, është realizuar ky projekt në shumën 4,800,000 lekë, ose në masën 100%.

-Sistem Exchange Server për hostimin e email zyrtar në infrastrukturën IT /ë sistemit gjyqësor, janë detajuar fonde buxhetore në shumën 67,072,000 lekë. Ky investim parashikon blerjen në vitin 2024, të një sistemi exchange email server “Exchange Server Enterprisë 2019 On premises”, për hostimin e postës elektronike zyrtare të stafit të gjykatave me qëllim që për arsye sigurie posta elektronike të jetë e konfiguruar dhe hostuar në Infrastrukturën IT në KLGJ dhe jo më tek AKSHI.

[30] Raporti i monitorimit të buxhetit të KLGJ për periudhën janar-dhjetor 2024

[31] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 29. <https://klgj.al/media/lbhp5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

Vlera e planifikuar e këtij projekti është prokuruar dhe është lidhur kontrata në muajin maj në shumën 67,072,000 lekë. Ka përfunduar realizimi këtij projekti në shumën e kontraktuar 64,776,910 lekë ose në masën 97%.

Projekti 21AC501-“Programe Software për gjykatat”, për vitin 2024 është realizuar në shumën 106,214,825 lekë ose në masën 92 %.

Projekti 21AC401 [32] “Blerje pajisje për infrastrukturën elektronike”, janë detajuar fonde buxhetore në shumën 50,000,000 lekë. Fondi është rishikuar (shtuar) në shumën 17,550,000 lekë.

Projekti 21AC401 “Blerje pajisje për infrastrukturën elektronike ” në shumën 67,550,000 lekë, është realizuar plotësisht në shumën 67,548,000 lekë, ose në masën 100%.

Projekti J8AD80I “Blerje orendi dhe pajisje zyre” në shumën 23,272,100 lekë është realizuar gjatë viti 2024, në shumën 12,908,126 lekë ose në masën 56%. Realizimi në këtë masë është i lidhur me mosrealizimin e plotë të fondit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm e cila ka refuzuar marrjen në dorëzim të mallit të kontraktuar për shkak të mosplotësimit nga Operatori Ekonomik të specifikimeve teknike të kontraktuara.

Risku i buxhetit të KLGJ

Tek regjistri i riskut të KLGJ për vitin 2024, është parashikuar si risk i mesëm ‘mosadministrimi në kohën e duhur të kërkesave buxhetore, të ardhura nga gjykatat e të gjitha niveleve’. Po ashtu me risk të mesëm është parashikuar edhe ‘mospërgatitja brenda afateve të dokumentit përfundimtar të PBA dhe paraqitjen e tij për shqyrtim në Komision dhe seancë plenare’[33].

Nga monitorimi i zbatimit të buxhetit ka pasur një lëvizje të gjerë të buxhetit shumë prej të cilave në favor të gjykatave dhe nevojave të tyre.

Shpenzimet nga të ardhurat e krijuara

[33] Urdhër i KLGJ nr.17, datë 26.02.2024 “Për miratimin e regjistrimit të riskut të brendshëm në Këshillin e Lartë Gjyqësor, 2024”

Gjykatat në zbatim të VKM dhe udhëzimit të MF e MD, kanë përdorur edhe të ardhurat e krijuara prej tyre[34].

Për vitin 2024, realizimi i shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit (vetëm për programin 03310 - Buxheti Gjyqësor) është në shumën 20,590,177.8 lekë nga të cilat në shumën 11,927,197 lekë në mallra dhe shërbime (Art.602) dhe në shumën 8,662,980.8 lekë në shpenzime kapitale (Art 230 dhe 231).

Kosto për njësi, çështje të shqyrtuara

Numri i çështjeve të parashikuara për vitin 2024, ishte 148,800 çështje.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 128,812 të tilla ose 87% e numrit të planifikuar.

Për realizimin e 128,812 çështjeve janë shpenzuar 4,114,928,779 lekë (shpenzime korente), ose mesatarisht 31,945 lekë /çështje, kundrejt 28,289 lekë/çështje sipas buxhetit të rishikuar. Rritja e shpenzimeve mesatare/çështje është e lidhur me ndryshimet ligjore në paga, si dhe mosrealizimi i plotë i numrit të çështjeve si rezultat i vakancave në sistemin gjyqësor. Megjithatë siç duket edhe nga tabela më poshtë kosto për çështje në gjyqësor ka rënë në krahasim me vitin 2023.

Tab: Kosto mesatare për njësi të produktit ‘çështje të gjykuara’ në gjyqësor 2019-2024

Vitet	Nr i çështjeve të gjykuara	Kosto për produktin/lekë	Kosto për njësi/lekë
2019	153,989	2,392,685	15,538
2020	128,374	2,418,546,000	18,839
2021	142,491	2,486,572,000	17,450

[34] VKM nr. 432, datë 08.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore", si dhe Udhëzimit të Përbashket të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Drejtësisë nr. 33, datë 29.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore"

Vitet	Nr i çështjeve të gjykuara	Kosto për produktin/lekë	Kosto për njësi/lekë
2022	131,865	2,659,597,000	15,538
2023	119,802	3,999,474,025	18,839
2024	128812	4,114,928,779	17,450

Nevojat buxhetore [35]

Për vitin buxhetor 2025 buxheti i miratuar për sistemin gjyqësor është në shumën 6,159,959 mijë lekë [36] (nga e cila shuma prej 105,000 mijë lekë është financim i huaj).

Nevojat e evidentuara nga KLGJ-ja kanë qenë rreth 41% më të larta se buxheti i miratuar dhe akorduar, ose në vlerë absolute 2,520,569 mijë lekë.

Kërkesa për burime njerëzore shtesë nga Këshilli ishte akordimi i 272 punonjësve shtesë, Kuvendi ka miratuar 133 punonjës shtesë, për vitin 2025.

Shpenzimet korrente - Për vitin 2025, fondet e miratuara në shpenzime korrente janë më të pakta krahasuar me kërkesat buxhetore të paraqitura.

Shpenzimet kapitale (investime) - Fondet e miratuara për shpenzime kapitale, për vitin 2025, janë më të larta se viti i mëparshëm.

Projektet kryesore për t'u realizuar gjatë vitit 2025 janë [37]:

[35] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 46. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

[36] Ligji nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"

[37] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 47. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

Projekti për zhvillimin e një Sistemi të ri të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, i cili është planifikuar, për një kohëzgjatje 5-vjeçare, sipas vlerësimit në udhërrëfyesin e Këshillit të Evropës.

Projekti Enterprise Service BUS (ESB), është parashikuar të realizohet në një periudhë 3-vjeçare. Implementimi i një ESB do të ndihmojë KLGJ-në, me qëllim për të ofruar një qasje të unifikuar për komunikimin midis shërbimeve.

Projekti “Rritja e kapaciteteve të sigurisë kibernetike”, është parashikuar të realizohet në një periudhë 3-vjeçare.

Është emergjente përmirësimi i infrastrukturës ndërtimore nëpërmjet ndërtimit të godinave të reja për Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Fier, Lezhë, Kukës dhe Durrës. Kërkesat për realizimin e këtyre projekteve kanë qenë pjesë edhe e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

Drejtori i buxhetit në KLGJ, Xhevdet Haxhiu tha se ende nuk mund të quhet e zgjedhur çështja e hapësirave të gjykatave pavarësisht se kemi ambiente të shtuara për gjykatën në Durrës dhe gjykatën e Apelit JP. Në lidhje me kushtet e punës duhet të kalojmë tej grupi A, tani jemi tek grupi B. Çështja e gjykatave nuk quhet e zgjidhur deri në vendosjen e tyre në ndërtesa të reja [38].

Marrje me qera

Në kushtet kur nuk ka një zgjidhje nga qeveria apo pushteti lokal për një shesh ndërtimi dhe më pas financimin për ndërtimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, KLGJ ka bërë thirrje për marrje ambientesh me qera në fund të vitit 2024. Kërkesa është për një ambient afërsisht 7000-8000 metra katror dhe jo më shumë se 3 km larg nga qendra e Tiranës me akses në transportin publik.

Thirrja është përsëritur edhe njëherë në fillim të vitit 2025. Marrja me qera dështoi për shkak të mosparaqitjes së ofertave.

Prokurimet

Për vitin 2024 ishin parashikuar 40 procedura prokurimi ndërsa deri në fund të vitit janë realizuar 33 procedura.

Në disa raste ka një ulje të ndjeshëm të vlerës së prokuruar nga ajo e përcaktuar më herët siç është rasti i blerjes së softwareve me një zbritje afro 38%; mirëmbajtja e pajisjeve audio me afro 35%. Por ka edhe blerje në vlerë të vogël që janë sa gjysma e buxhetit të planifikuar si në rastin e blerjes së furçave.

Ndërsa konstatohen raste kur të dy vlerat si ajo e shpallur, edhe ajo e prokuruar janë njësoj siç ka ndodhur në blerjen e karburantit.

Auditimi i gjykatave

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm [39] në Këshillin e Lartë Gjyqësor ka kryer disa auditime gjatë vitit 2024 dhe ka listuar përmes një raporti vjetor të veprimtarisë së kësaj drejtorie gjetjet dhe rekomandimet në 7 gjykata.

Janë kryer 7 auditime në subjekte të ndryshme dhe 1 auditim për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të vitit 2023.

Disa nga gjetjet e auditimeve në gjykata që lidhen me përdorimin e financave dhe shpenzimin e buxhetit janë theksuar që në përmbledhje të raportit vjetor [40].

Tek prokurimet janë vënë re probleme në përllogaritjen e fondit limit, në specifikimet teknike, në vendosjen e kriterëve të veçanta për kualifikim, dhe në zbatimin e kontratave, veçanërisht për furnizimet me karburant. Tek pagat dhe shpërblimet, ka raste të pagesave në kategori më të larta për komandime të përkohshme dhe mosrespektimin e përcaktimeve për nivelin e diplomës në trajtimin financiar të disa pozicioneve. Tek transaksionet për blerje dhe shpenzime evidentohen mangësi në pagesat për avokatë, ekspertë, përdorimin e mjeteve monetare në cash, si dhe në administrimin e karburantit. Ka problematika në regjistrimet kontabël, hartimin e pasqyrave financiare dhe administrimin e letrave me vlerë, në përditësimin e librit të aktiveve, lëvizjen, transferimin dhe inventarizimin e tyre.

Dëm ekonomik është evidentuar në një subjekt – Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër – në shumën 93,000 lekë, në sistemin e pagave dhe shpërblimeve.

Gjatë vitit 2024 janë dhënë gjithsej 83 rekomandime për 8 auditimet e realizuara, një rritje prej 11 rekomandimesh krahasuar me vitin 2023. Të gjitha subjektet i kanë pranuar rekomandimet dhe kanë hartuar plane veprimi për zbatimin e tyre.

Auditi i brendshëm ka rekomanduar në fund të kontroleve të veta 83 masa [41].

[39] Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar. Pika 4.3 e Kapitullit IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016

[40] Raporti i veprimtarisë të auditimit të brendshëm, për vitin 2024, KLGJ, f.2-3

[41] Raporti i veprimtarisë të auditimit të brendshëm, për vitin 2024, KLGJ, f.23-26

Në lidhje me çështje që prekin financat, rekomandimet theksojnë nevojën e dokumentimit të të gjitha hapave në prokurime, përfshirë specifikimet teknike, përlllogaritjen e fondit limit dhe vendosjen e kriterëve për kualifikim; arkivimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimit; përmirësimi i administrimit të karburantit dhe aktiveve; rishikimin e pagesave të përfituara padrejtësisht nga punonjës të komanduar pa bazë ligjore; caktimi i punonjësve me përgjegjësi për mjete monetare dhe letrat me vlerë; mbajtja dhe dokumentimi i saktë i veprimeve monetare; sistemimi i llogarive në pasqyrat financiare.

Stoku i çështjeve

Gjyqësori në Shqipëri në fund të vitit 2024 numëroi 136.916 çështje të pazgjidhura ose stok me një ulje të lehtë të tij krahasuar me vitin 2023 kur stoku ishte 139.896.

Në gjykatën e Lartë vlera e stokut ka pësuar ulje në krahasim me një vit më parë me 19.8%, duke zbritur në 20,888 çështje në fund të vitit 2024 nga 26,058 çështje që ishin në fillim të vitit.

Në gjykata e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm në fund të vitit 2024 stoku i çështjeve arriti në 41700 çështje nga 37662 çështje që ishte në fillim të vitit 2024, me një rritje prej 10.7% ose 4,038 çështje më shumë se një vit më parë.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka ruajtur një nivel të ulët të backlog-ut. Në fillim të vitit 2024, backlog-u ishte 25 çështje dhe në fund të vitit, backlog-u mbeti i stabilizuar në 25 çështje.

Në GJKKO në fund të vitit 2024 mbeten në pritje për t'u shqyrtuar 169 çështje, nga 126 që ishin në vitin 2023.

Gjykata Administrative e Apelit në fund të vitit 2024, numëroi 23,862 çështje stok, me një shtesë prej 806 çështjesh ose 3.5% krahasuar me vitin 2023. Rreth 29.6% e backlog-ut përbëhet nga çështje që presin gjykim për më shumë se 5 vjet, duke kaluar afatet e arsyeshme të gjykimit.

Në gjykatat administrative të shkallës së parë në Tiranë dhe Lushnjë [42], stoku në fund të vitit 2024 është 8,396 çështje [43], duke shënuar një ulje të lehtë prej 4.5% krahasuar me vitin paraardhës.

[42] Zv/kryetari i gjykatës administrative të Lushnjës, Edison Tatoshaj premtoi se brenda një viti e gjysëm gjykata do të evadonte të gjitha çështjet stok pasi prej vjeshtës së 2024, numri i gjyqtarëve është i plotë, 9 gjithsej nga 5 që ishin në vitet 2023-2024, Forumi Civil, 28 mars 2025, Lushnjë

[43] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 47. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>


Në përfundim të vitit 2024, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm raportojnë një total prej 42,070 çështjesh të mbetura në pritje të shqyrtimit. Kjo shifër përfaqëson një ulje të lehtë prej rreth 4% krahasuar me backlog-un e vitit paraardhës, i cili ishte 43,853 çështje.

Tab: Varianca e stokut në gjyqësor për vitet 2022-2024 në të gjitha gjykatat

Gjykatat/vitet	2022	2023	2024
Gjykata e Lartë	31827	26058	20888
GJKKO	152	126	169
GJAKKO	34	25	25
Apeli i Juridiksionit të Përgjithshëm	31370	37662	41700
Apeli Administrativ	21166	23056	23862
Gjykatat e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm	40866	44181	42070
Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë	7354	8788	8396
Total	132008	139.896	136.916

[42] Zv/kryetari i gjykatës administrative të Lushnjës, Edison Tatoshaj premtoi se brenda një viti e gjysëm gjykata do të evadonte të gjitha çështjet stok pasi prej vjeshtës së 2024, numri i gjyqtarëve është i plotë, 9 gjithsej nga 5 që ishin në vitet 2023-2024, Forumi Civil, 28 mars 2025, Lushnjë

[43] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 47. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>



Treguesit e efektivitetit

KL Gj-ja në raportin e vet vjetor përveç stokut total BT, bazuar në metodologjinë e CEPEJ-it [44], përpunon dhe analizon 5 indikatorë apo tregues të funksionimit të gjykatës, të tillë si: ngarkesa mesatare për gjyqtar (treguesi WR), rendimenti mesatar për gjyqtar (treguesi ER), norma e zgjidhjes së çështjeve (treguesi CR), raporti i qarkullimit të çështjeve (treguesi RQC) dhe koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (treguesi DT).

Tab: Indikatorët e eficensës së gjyqësorit në vitin 2023-2024

Viti	2023	2024	2023	2024
Gjykatatat/Indikator	DT (ditë)	DT (ditë)	CR %	CR %

[44] Metodologjia CEPEJ e përkthyer në vendimin 47, datë 11.02.2021 të KLGJ-së, përpunon disa indikatorë apo tregues bazë të funksionimit të gjykatës, të tillë si: (i) Ngarkesën e punës në secilën gjykatë; (ii) Gjendjen e backlog-ut në gjykatë; (iii) Prurjet e çështjeve të reja në gjykatë; (iv) Ngarkesën mesatare të gjyqtarëve (Treguesi ER); (v) Normën e eficensës (Treguesi ER); (vi) Raportin e qarkullimit të çështjeve (Treguesi RQC); (vii) Kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes (Treguesi DT); (viii) Normën e zgjidhjes së çështjes (Treguesi CR); (ix) Vjetërsinë (moshën) e çështjes etj

Gjykata e Lartë	2087 (civile)	1690.4	265.2	357
GJKKO	16.4	18	100.9	99
GJAKKO	30.7	14.5	103.3	102.3
Apeli i Juridiksionit të Përgjithshëm	2790.7 (civile)	2683	52	64.2
Apeli Administrativ	5326	3,275.5	46	76.7
Gjykatat e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm	193	256	94.5	103
Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë	272 (civile)	236	90	100

Gjykata e Lartë

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar WR është ulur me 23% të tij, konkretisht në 1,602.6 çështje në vitin 2024 nga 2,084.2 çështje për gjyqtar në vitin 2023. Numri i gjyqtarëve efektivë është rritur nga 16.3 në vitin 2023 në 17.8 në vitin 2024, duke ndihmuar në shpërndarje më të barabartë të ngarkesës së punës.

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar ER në vitin 2024, për Gjykatën e Lartë, pëson rënie me 11.6% duke arritur në 429.2 çështje për gjyqtar nga 485.5 çështje për gjyqtar që ishte në vitin 2023.

Norma e likuidimit të çështjeve penale CR është rritur me 4%, duke arritur në 275.8% [45] nga 265.2% në vitin 2023 [46].

Koha për evadimin e çështjeve DT civile është ulur në 1690.4 ditë, nga 2087.7 ditë në vitin 2023. Koha për evadimin e çështjeve administrative është ulur në 830.3 ditë, nga 932.5 ditë në vitin 2023. Koha për evadimin e çështjeve penale është ulur në 282 ditë, nga 497.9 ditë në vitin 2023.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Ngarkesa e përgjithshme e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024 rezultoi në 51,550 çështje ose 5,673 çështje më shumë se në vitin 2023.

Ngarkesa mesatare për gjyqtar, ËR është rritur në 1,945.3 çështje për gjyqtar në vitin 2024 nga 1,903.6 çështje në vitin 2023.

Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) paraqitet në vlerën 371.1 çështje për gjyqtar, ndërsa në vitin 2023 ishte 340.9.

Normës e likuidimit të çështjeve CR është 64.2% për çështje civile dhe 76% për çështjet penale duke shënuar rritje në krahasim me vitin 2023.

Treguesi DT (koha mesatare e gjykimit) për çështjet civile ka rënë nga 2790.7 ditë në 2683 ditë (-4%); ndërsa për çështjet penale ka rënë nga 885.2 ditë në 823 ditë (-7%).

Mesatarisht, treguesi DT për të gjitha çështjet është ulur nga 1673.4 ditë në 1545.2 ditë [47].

Gjykata ka funksionuar me vetëm 1/3 e numrit të miratuar të gjyqtarëve duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e backlog-ut.

[45] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 47. <https://klgj.al/media/1bhp5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

[46] Shpjegim: Në raportin vjetor të KLGJ për vitin 2023 CR për gjykatën e lartë është llogaritur 369%.

[47] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 94. <https://klgj.al/media/1bhp5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

Gjykata e Posaçme e Apelit

393 çështje të reja u regjistruan në vitin 2024, 36.5% më shumë se në vitin 2023, duke shënuar numrin më të lartë të regjistrimeve në 5 vitet e fundit.

Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) u rrit me 46%, ku çdo gjyqtar trajtoi mesatarisht 43.2 çështje, krahasuar me 29.7 çështje në vitin 2023.

Norma e likuidimit të çështjeve (CR) ishte 102.3%, duke treguar që gjykata arriti të përfundonte të gjitha çështjet e reja të regjistruara dhe të reduktonte stokun e mbetur nga viti i kaluar.

Koha mesatare për evadimin e një çështjeje (DT) u ul me 50%, nga 30.7 ditë në vitin 2023 në 14.5 ditë në vitin 2024. 98.3% e çështjeve u përfunduan brenda 6 muajve, duke treguar një ritëm të shpejtë të procesit gjyqësor.

GJKKO

Gjatë vitit 2024 në GJKKO janë regjistruar 3459 çështje të reja, me rritje të numrit të çështjeve të reja me 684 çështje ose rreth 25 % më shumë se viti 2023. Në krahasim me vitin 2022 kjo rritje e numrit të çështjeve të vitit 2024 është në masën 1400 çështje ose rreth 68% çështje më shumë.

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (ER) i cili shpreh numrin mesatar të çështjeve të përfunduara nga një gjyqtar, gjatë vitit të raportuar për vitin 2024, ishte 331 çështje për gjyqtar.

Norma e zgjidhjes së çështjeve (CR) në vitin 2024 ka mbajtur vlerën 99%.

Koha e nevojshme për likuidimin e çështjeve (DT) për vitin 2024 është 18 ditë, dy ditë më shumë se vitin e kaluar prej 16.4 ditë.

Gjykata administrative e Apelit

Numri i çështjeve të reja në vitin 2024 është 3,465, pothuajse i njëjtë me një vit më parë (vetëm 5 çështje më pak).

Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) u rrit me 21% krahasuar me vitin 2023, ku çdo gjyqtar trajtoi mesatarisht 231.2 çështje për vitin 2024.

Norma e likuidimit të çështjeve (CR) ka arritur nivelin më të lartë në tre vitet e fundit, duke shënuar 76.7%.

Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (DT) u ul me 38.5%, duke arritur në 3,275.5 ditë krahasuar me vitin paraardhës ose afërsisht 9 vjet.

Gjykatat administrative të shkallës së parë

Gjatë vitit 2024, janë regjistruar 14,370 çështje të reja, duke shënuar një rënie prej 6.9% krahasuar me vitin paraardhës. Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) është përmirësuar me 40% në Tiranë dhe 11% në Lushnjë, duke reflektuar një rritje të numrit të çështjeve të gjykuara për gjyqtar.

Norma e likuidimit të çështjeve (treguesi CR) është mbi 100.

Gjykata Administrative e Tiranës ka ulur kohëzgjatjen mesatare të zgjidhjes të çështjeve me 18 ditë (-8.4%), pra nga 254 në 236 ditë, ndërsa Gjykata e Lushnjës ka ulur këtë kohë me 45 ditë (-15.5%).

Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Gjatë vitit 2024, ngarkesa totale e punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ka arritur në 128,573 çështje. Ky volum përfshin tërësinë e çështjeve që janë në shqyrtim nga këto gjykata, të cilat përbëhen nga backlog-u i mbetur nga viti i mëparshëm si dhe çështjet e reja të regjistruara gjatë vitit 2024.

Ngarkesa mesatare e punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm për vitin 2024 ishte rreth 750 çështje për gjyqtar, duke shënuar një rënie prej 92 çështjesh ose rreth 11% krahasuar me vitin 2023, kur kjo vlerë ishte mesatarisht 841.7 çështje për gjyqtar.

Gjykata e Gjirokastrës paraqitet me 1010 çështje për gjyqtar.

Gjykata e Elbasanit dhe Gjykata e Tiranës kanë tregues të ngjashëm, përkatësisht 1001.4 dhe 1005.9 çështje për gjyqtar.

Gjykata e Kukësit ka 396 çështje për gjyqtar, ndërsa në Dibër 418.4 çështje, duke qenë gjykatat me ngarkesën më të ulët për gjyqtar.

Në vitin 2024, vlera mesatare e treguesit ER, për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm është 516 çështje për gjyqtar, një rënie me 31 çështje ose 5.7% më pak krahasuar me vitin 2023.

Në vitin 2024, mesatarja e normës së likuidimit të çështjeve, (CR) për çështjet civile në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ka arritur në 103%, duke shënuar rritje prej 13 për qind krahasuar me vitin 2023, kur ky tregues ishte 90%.

Gjykatat që kanë arritur të përmbushin dhe tejkalojnë pragun 100% të CR për çështjet civile janë: Durrës, Fier, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Gjykata e Dibrës ka një tregues CR për çështjet civile prej 100%, çka tregon se ka përballuar plotësisht fluksin e çështjeve të reja, pa ndikuar pozitivisht apo negativisht në stokun ekzistues.

Gjykatat që kanë tregues CR nën 100% janë: Berat, Elbasan dhe Gjirokastrë.

Vlera mesatare e treguesit DT për çështjet civile në vitin 2024 është 256 ditë, krahasuar me 272 ditë në vitin 2023, çka përfaqëson një përmirësim prej 16 ditësh ose një reduktim me 5.8%. Vlera mesatare e treguesit DT për çështjet penale në vitin 2024 është 97 ditë, kundrejt 114 ditëve në vitin 2023.

Në zbatimin të rekomandimit të dytë të rezolutës së Kuvendit për vitin 2023, gjatë vitit 2024 janë shënuar përmirësime në adresimin e stokut.

Në rekomandimin nr. 2 kërkohej që “Brenda muajit dhjetor 2024 KLGJ të informojë Kuvendin me të dhëna statistikore për performancën e sistemit gjyqësor pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, si dhe për problematikat në lidhje me të”. KLGJ ka konstatuar se ‘edhe pse ka kaluar vetëm 1 vit nga zbatimi i plotë i Hartës së Re Gjyqësore, janë vënë re disa përmirësime të ndjeshme në disa tregues kyç të efikasitetit në sistemin gjyqësor. Në shtator 2024 norma e zgjidhjes së çështjeve (CR) arriti në 95.9%, çfarë përbën rritje krahasuar me 90.5% në shtator 2023 dhe 89.2% në shtator 2022. Një faktor i rëndësishëm që ndikon negativisht në treguesit e efikasitetit të sistemit gjyqësor është mungesa e burimeve njerëzore/ gjyqtarëve. Plotësimi i këtyre mungesave, në përputhje me strukturën organizative të çdo gjykate, si dhe rritja e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve që Këshilli ka miratuar, do të kontribuojnë në përmirësimin e treguesve të efikasitetit të sistemit gjyqësor’ [48].

Adresimi i stokut nga KLGJ, strategjia kombëtare për uljen e stokut, plani i veprimit

[48] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 26. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

KL Gj ka ngritur grupin e punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” të ndryshuar, me Urdhrin nr.42, datë 20.07.2023, të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor .

Grupi i punës [49] kishte në fokus kryesisht gjykatat e apelit si dhe gjykata të tjera të konsideruara në nevojë.

Në përbërje të tij ishin anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, drejtues të gjykatave kryesore, si dhe përfaqësues nga Këshilli i Evropës, nga projektet INL/EËMI, EU4Justice etj.

Detyrat kryesore të grupit të punës ishin: Vlerësimi dhe analizimi i situatës lidhur me numrin e çështjeve të prapambetura në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatat e Shkallës së Parë Administrative dhe në Gjykatën Administrative të Apelit; Identifikimi i shkaqeve të krijimit të stokut të çështjeve të prapambetura dhe propozimi i masave konkrete për zgjidhjen dhe adresimin e tij; Hartimi i një plan veprimi me masa konkrete që grupi do të vlerësojë të nevojshme. Grupi i Punës u mbledh 13 herë deri në miratimin e kësaj strategjie.

Strategjia përcakton përmasat e problemeve në gjykata, të cilat shkaktojnë volumnin e madh të çështjeve të prapambetura, ofron një perspektivë për sa i përket skenarëve për pakësimin e tyre në tri vitet e ardhshme, si dhe prezanton masa praktike për uljen e çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e tyre në të ardhmen, duke ofruar, gjithashtu, një sërë masash ligjore të nevojshme për uljen e çështjeve të prapambetura dhe përmirësimin e efikasitetit të drejtësisë në gjykatat shqiptare. Strategjia [50] ka përcaktuar 7 objektivat tre prej të cilëve (1,2,4) adresojnë direkt çështjen e stokut ndërsa 4 të tjerë synojnë përmirësimin e ambientit që do të sjellë reduktimin e stokut.

Strategjia synon realizimin e 7 objektivave në vijim:

Objektivi 1: Ulja strukturore e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë, në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 2024 – 2027 nëpërmjet marrjes së masave konkrete.

Objektivi 2: Fuqizimi i kapaciteteve në gjykata me marrjen e masave për emërimin dhe përsheptimin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, heqjen e pengesave për përzgjedhjen, trajnimin dhe emërimin e ndihmësve ligjorë në gjykata dhe rritjen në përgjithësi të numrit të stafit mbështetës jo gjyqtar.

Objektivi 3: Përmirësimi i metodave dhe proceseve të punës.

[49] Urdher nr.42, 20.07.2023 “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”

[50] Strategjia Kombëtare e Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata, 2024-2027

KLGIJ ka ngritur grupin e punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” të ndryshuar, me Urdhrin nr.42, datë 20.07.2023, të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor .

Grupi i punës [49] kishte në fokus kryesisht gjykatat e apelit si dhe gjykata të tjera të konsideruara në nevojë.

Në përbërje të tij ishin anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, drejtues të gjykatave kryesore, si dhe përfaqësues nga Këshilli i Evropës, nga projektet INL/EËMI, EU4Justice etj.

Detyrat kryesore të grupit të punës ishin: Vlerësimi dhe analizimi i situatës lidhur me numrin e çështjeve të prapambetura në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatat e Shkallës së Parë Administrative dhe në Gjykatën Administrative të Apelit; Identifikimi i shkaqeve të krijimit të stokut të çështjeve të prapambetura dhe propozimi i masave konkrete për zgjidhjen dhe adresimin e tij; Hartimi i një plan veprimi me masa konkrete që grupi do të vlerësojë të nevojshme. Grupi i Punës u mbledh 13 herë deri në miratimin e kësaj strategjie.

Strategjia përcakton përmasat e problemeve në gjykata, të cilat shkaktojnë volumin e madh të çështjeve të prapambetura, ofron një perspektivë për sa i përket skenarëve për pakësimin e tyre në tri vitet e ardhshme, si dhe prezanton masa praktike për uljen e çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e tyre në të ardhmen, duke ofruar, gjithashtu, një sërë masash ligjore të nevojshme për uljen e çështjeve të prapambetura dhe përmirësimin e efikasitetit të drejtësisë në gjykatat shqiptare. Strategjia [50] ka përcaktuar 7 objektivat tre prej të cilëve (1,2,4) adresojnë direkt çështjen e stokut ndërsa 4 të tjerë synojnë përmirësimin e ambientit që do të sjellë reduktimin e stokut.

Strategjia synon realizimin e 7 objektivave në vijim:

Objektivi 1: Ulja strukturore e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë, në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 2024 – 2027 nëpërmjet marrjes së masave konkrete.

Objektivi 2: Fuqizimi i kapaciteteve në gjykata me marrjen e masave për emërimin dhe përsheptimin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, heqjen e pengesave për përzgjedhjen, trajnimin dhe emërimin e ndihmësve ligjorë në gjykata dhe rritjen në përgjithësi të numrit të stafit mbështetës jo gjyqtar.

Objektivi 3: Përmirësimi i metodave dhe proceseve të punës.

Objektivi 4: Prezantimi i një pakete ndryshimesh ligjore që synojnë uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe zbatimin e masave konkrete për uljen dhe parandalimin e krijimit të çështjeve të prapambetura në gjykata në të ardhmen.

[49] Urdher nr.42, 20.07.2023 "Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata"

[50] Strategjia Kombëtare e Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata, 2024-2027

Objektivi 5: Përcaktimi i standardeve minimale kohore dhe sasore dhe matja e performancës së gjyqtarëve.

Objektivi 6: Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional me aktorë të tjerë brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë.

Objektivi 7: Rritja e Transparencës dhe forcimi i besimit të publikut në sistemin gjyqësor .

Përgjatë strategjisë nuk preket askund ndikimi i financave në krijimin e stokut, çfarë përjashtohet si faktor për krijimin e tij por ndërkohë segmente të strategjisë shtrojnë nevojën e rritjes së financimit të sistemit sidomos në zërin e pagave përmes rritjes së numrit të punonjësve.

Për shembull strategjia parashikon edhe rritjen e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit në 19 pozicione gjyqtarësh (krahasuar me 13 pozicione që ka aktualisht); rritja e numrit dhe thjeshtimi i procesit të punësimit të ndihmësve ligjorë/stafit tjetër mbështetës jo gjyqtar. Propozohet rritja e numrit të ndihmësve ligjorë deri në dy ndihmës ligjorë për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, rritja e trajtimit të tyre financiar si një mjet nxitës për përzgjedhjen e kësaj karriere nga ana e profesionistëve të së drejtës (objektivi 2).

Objektivi 3 thekson nevojën e shkëmbimit të versioneve elektronike të dokumenteve gjyqësore si vendimeve gjyqësore ndërmjet gjykatave apo aktorëve të tjerë në proces [51] dhe modeleve standarde për vendimet gjyqësore/ urdhrat e gjykatës dokumente të tjera [52]. Zbatimi i një mase të tillë kërkon mbështetje më të madhe financiare. Por edhe një masë tjetër në ndihmë të realizimit të objektivit 3 është edhe zhvillimi i seancave gjyqësore në distancë e cila kërkon sërish investime në rrjete e sisteme digjitale.

Propozimet e mësipërme që ndjekin objektivat sidomos objektivin 4 janë shoqëruar me propozime për ndryshime ligjore.

[51] Shpjegim: Në vend të një praktike ku personeli i gjykatës duhet të rishkruajë elementet e një vendimi gjyqësor në një relacion që do të përgatitet për gjyqtarët (në rast të mungesës së një versioni elektronik të një vendimi gjyqësor) apo elementet e ankimeve a kërkesave me karakter të ndryshëm, stafi mbështetës i një gjykate, mund të përdorë drejtpërdrejt një version digjital të tyre nëpërmjet shkëmbimit të formatit elektronik midis gjykatave apo edhe nëpërmjet të forcimit të bashkëpunimit me aktorë të tjerë në proces si përfaqësuesit ligjor, prokurorët, ekspertët etj. Për çështjet e vjetra, përdorimi nga gjykata të skanerëve sikursepo ndodh aktualisht për vendimet gjyqësore, mund të ndihmojnë krijimin e skedarëve digjitalë dhe të redaktueshëm, të cilët do të kursejnë kohë të vlefshme për përgatitjen e çështjeve sidomos në gjykatat e apelit.

[52] Shpjegim: Modelet standarde mund të kontribuojnë pozitivisht në reduktimin e kohës së nevojshme që gjyqtarët, ndihmësit ligjorë dhe sekretarët gjyqësorë apo stafi tjetër mbështetës jo gjyqtar, shpenzojnë për hartimin dhe conceptualizimin e vendimeve dhe urdhrave të gjykatës. Projektet pilot të mëparshme të zbatuara në gjykatat shqiptare kanë treguar se, për shembull, në fushën e urdhrave të ekzekutimit, përdorimi i shablloneve mund të ndihmojë në kufizimin e kohës së punës të shpenzuar gjatë fazës paraprake dhe në hartimin e vendimeve/urdhrave. Gjithashtu është e nevojshme hartimi i modeleve standarde për hartimin e relacionit nga ana e ndihmësve ligjorë apo akteve të tjera të nevojshme gjatë gjyqimit që mund të përdoren nga sekretarët gjyqësorë apo stafi tjetër mbështetës jo gjyqtar.

Ndërkaq KLGJ disa nga këto propozime i ka dërguar në ministri të Drejtësisë dhe Kuvend që në korrik të vitit 2023 ndërsa në qershor të vitit 2022 ka propozuar disa ndryshime ligjore që konsistojnë në përmirësimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen e kryetarëve të gjykatave. Ende këto propozime ndodhen në fazë konsultimi pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

Ashtu si në projektin e hartës së re gjyqësore edhe në rastin e Strategjisë Kombëtare për uljen e stokut të çështjeve të prapambetura në gjykata, projekti nuk është shoqëruar me një paketë financiare të nevojshme për të mbështetur objektivat e strategjisë. Disa nga këto objektiva dalin përtej kapaciteteve të KLGJ si dhe jashtë burokracisë institucionale siç është nevoja për konsolidimin e praktikave digjitale në menaxhimin e çështjeve apo dosjeve në gjykata. Ato kanë nevojë për investime dhe para, që strategjia nuk i ka parashikuar as si një zë më vete as në planin e veprimit që shoqëron strategjinë.

Megjithatë tek konkluzionet dhe angazhimit raporti i KLGJ për vitin 2024 theksohet se Këshilli i Lartë Gjyqësor [53] kërkon mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me: Miratimin e ndryshimeve ligjore të propozuara dhe të dërguara në Kuvend (i) nga grupi i punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”, të cilat synojnë uljen e ngarkesës dhe rritjen e efikasitetit, (ii) ndryshimet e propozuara ligjore në lidhje me eksperiencën minimale të nevojshme për t’u zgjedhur kryetar gjykate (iii) si edhe atyre që lidhen me rritjen e transparencës përmes publikimit të informacionit mbi statusin e gjyqtarëve, në mënyrë të plotë dhe të paanonimizuar. Mbështetje financiare për vazhdimësinë e realizimit të projekteve të investimeve në infrastrukturën e IT-së për sistemin gjyqësor, si dhe rritjen e fondeve në shpenzime kapitale (investime) në përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore, në disa gjykata të vendit (gjykata e apelit, gjykatave të shkallës së parë Fier, Tiranë, Durrës dhe Lezhë).

Transparenca

Tek Programi i transparencës është edhe këndi ‘Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve’.

Gjatë vitit 2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka trajtuar në total 49 kërkesa për informacion bazuar në ligjin “Për të drejtën e informimit”, nga të cilat 44 kërkesa janë trajtuar me përgjigje të plotë, 4 kërkesa janë deleguar pranë autoritetit kompetent dhe 1 kërkesë është refuzuar për shkak se është vlerësuar se dhënia e një informacioni të tillë cenonte të dhënat personale të të tretëve.

Për secilën kërkesë janë publikuar përgjigjet ose të dhëna rreth përgjigjeve, duke pasur parasysh edhe kufizimet që lidhen me të dhënat personale.

[53] Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor 2024, fq 26. <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

Përgjigjet për kërkesat janë të detajuara dhe funksionale por në disa raste kur përgjigjet e kërkesës përmbajnë dokumente nuk janë afishuar bashkëngjitur edhe ato dokumente.

Koha e përgjigjes së kërkesave është brenda afatit ligjor prej 10 ditësh.

KL Gj ka të publikuar në faqen e saj formularin tip ‘Kërkesë për informacion’ i cili është lehtësisht i aplikueshëm ndërsa janë të publikuara edhe kontaktet për median qoftë të gjykatësit për median qoftë të zyrtarit të marrëdhënieve me median në gjitha gjykatat e vendit. Kontaktet janë me emra dhe adresat e tyre të emailit, por jo numrat e telefonit.

Po ashtu në të njëjtin kënd është edhe formulari për ankesë shoqëruar me guidën e përdorimit apo plotësimit të formularit. Është e paqartë se pse ky lloj formulari kërkohet të shoqërohet më një formular kërkesë.

Në faqe është publikuar edhe një manual përdorimi për të gjithë ata që duan ta ndjekin mbledhjen e KLGJ online. Pjesëmarrja mundësohet pas një aplikimi.

Tek rubrika dokumentimi i mbledhjes plenare, depozitohen përmbledhje të mbledhjeve të KLGJ dhe vendimmarrja e tyre si dhe mbledhja e regjistruar në audio. Versioni në audio është në përgjithësi i qartë pa zhurma dhe lehtësisht i aksesueshem nga të interesuarit.

Tek ‘Programi i Transparencës’ dritarja ku shënohen të dhënat për buxhetin është pasqyruar raporti i monitorimit të buxhetit bashkë me anekset për vitin 2024 ndërkohë që janë pasqyruar edhe për vitet paraardhëse. Janë publikuar buxheti për vitin 2024 si dhe për vitet paraardhëse.

Tek dritarja për të dhënat e prokurimeve janë publikuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve.

Raporti vjetor për 2024 është miratuar me 23 prill 2025 ndërsa është publikuar më 23 maj 2024.

Gjetje dhe përfundime

KL Gj ka përfituar për vitin 2024 një buxhet në shumën 4,967,459, 000 lekë.

Kërkesat buxhetore për të gjithë sistemin gjyqësor (KL Gj–në, Gjykata dhe QTI) për vitin 2024, ishin programuar në shumën prej 7,331,450 mijë lekë. Kërkesat buxhetore ishin më të larta se tavan i miratuar në shumën 3,445,800 mijë lekë, ose në masën 89 % më shumë sesa tavanët e miratuar.

Buxheti i rishikuar vjetor për grupin buxhetor si rezultat i ndryshimeve të mësipërme është në shumën 4,909,719,958 lekë.

Realizimi vjetor, si grup buxhetor është në shumën 4,734,657,970.2 lekë ose në masën 96%. Nga të cilat: programi 01110 në masën 90%; programi 01140 në masën 76% dhe programi 03310 në masën 97%.

Buxheti u rishikua gjatë vitit 2024 të paktën në 11 raste.

Të gjitha kërkesat e gjykatave për shpenzime apo investime në vitin 2024 janë plotësuar 100% nga ana e KLGJ.

Buxheti i miratuar për vitin 2024 është afërsisht 17.5 euro/banor ndërkohë që mesatarja e vendeve të Evropës është 28.3 euro/banor, për vende me PBB më të vogël se 10,000 euro/banor.

Për vitin 2024 ishin parashikuar 40 procedura prokurimi ndërsa deri në fund të vitit janë realizuar 33 procedura. Në disa raste ka një ulje të ndjeshme të vlerës së prokuruar nga ajo e përcaktuar më herët siç është rasti i blerjes së softwareve me një zbritje afro 38%; mirëmbajtja e pajisjeve audio me afro 35%. Por ka edhe blerje në vlerë të vogël që janë sa gjysma e buxhetit të planifikuar si në rastin e blerjes së furçave.

Buxheti për KLGJ ka ardhur në rritje nga viti në vit, kështu buxheti për vitin 2024 është gati dyfishi i buxhetit në vitin 2019.

Buxheti për vitin 2025 është në shumën 6,159,959 mijë lekë [54] (nga e cila shuma prej 105,000 mijë lekë është financim i huaj).

Nevojat e evidentuara nga KLGJ-ja kanë qenë rreth 41% më të larta se buxheti i miratuar dhe akorduar, ose në vlerë absolute 2,520,569 mijë lekë.

Kërkesa për burime njerëzore shtesë nga Këshilli ishte akordimi i 272 punonjësve shtesë, Kuvendi ka miratuar 133 punonjës shtesë, për vitin 2025.

Tri gjykata të kategorisë së tretë i kanë dërguar një relacion KLGJ në lidhje me ngritjen e pagave. Relacioni flet për rreth 400 zyrtarë gjyqësorë që kërkojnë ngritje pagash.

Ashtu si në projektin e hartës së re gjyqësore edhe në rastin e Strategjisë Kombëtare për uljen e stokut të çështjeve të prapambetura në gjykata, projekti nuk është shoqëruar me një paketë financiare të nevojshme për të mbështetur objektivat e strategjisë. Disa nga këto objektiva dalin përtej kapaciteteve të KLGJ si dhe jashtë burokracisë institucionale ndërsa kanë nevojë për investime dhe para, që strategjia nuk i ka parashikuar as si një zë më vete as në planin e veprimit që shoqëron strategjinë.

[54] Ligji nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"

Është garantuar mbështetja financiare për krijimin dhe funksionimin e Sistemit të Ri të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS).

Është ngritur një grup pune për reformën për nëpunësin civil gjyqësor e cila përfshin miratimin e akteve nënligjor, hartimin e rregullave dhe vlerësimeve kategorive të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Në vitin 2025 është dhënë leja për ndërtimin e Gjykatës së Lartë, është dhënë një ndërtesë shtesë për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është shtuar një ndërtesë për gjykatën e Durrësit, nuk ka ndryshim të nevojave të gjykatave të shkallës së parë Fier, Tiranë dhe Lezhë.

Gjykata e Lartë ka kryer punime në nivel mirëmbajtje për disa meremetime në ambientet e godinës së kësaj gjykate.

Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë kryer rikonstruksion i ambienteve të godinës ekzistuese, kryesisht për rikonstruksionin e rrjetit elektrik e kompjuterik.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nuk është kryer përshtatja e dhomës së serverit në zbatim dhe në përputhje me “Standardet për ndërtimin e dhomës së serverit në gjykata” pasi nuk janë paraqitur oferta.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka funksionalizuar godinën e ish-Gjykatës së Apelit Durrës, për transferimin e dhomës civile.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka vënë në funksionim sistemin e kondicionimit ngrohje-ftohje.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka kryer përshtatjen e ambienteve të ish- Gjykatës Kurbin për arkivin e kësaj gjykate.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, është kryer rikonstruksioni i tarracës së godinës.

Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar janë blerë 3 ashensorë të rinj për godinën, ku ushtrojnë aktivitetin Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është investuar përshtatja e dhomës së serverit në zbatim dhe në përputhje me “Standardet për ndërtimin e dhomës së serverit në gjykata”. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit por nuk është bërë likuidimi i situacionit të punimeve për arsye të mosplotësimit të standardeve të punimeve.

Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë ka bërë rikonstruksionin dhe përshtatjen e ambienteve të ndërtesës së ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Gjykata e re është akomoduar në këtë ndërtesë dhe ka marrë gjithashtu edhe katin e tretë të saj, që përdorej më parë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Gjatë vitit GJKKO ka përcjellë në KLGJ, kërkesën për hartimin e projektit të zbatimit, të sistemit elektronik të ndërtesës për instalimin e një sistemi të ri ngrohje-ftohje-ventilim (BMS dhe VRF), përfundimi i të cilëve i hap rrugë realizimit të tyre gjatë vitit 2025, në shumën 6,850,000 lekë [55].

Ka vijuar financimi për disa projekte ekzistuese në fushën e teknologjisë së informacionit, në sistemin gjyqësor.

Gjykatat Administrative, si në shkallën e parë ashtu edhe në apel, kanë treguar një përmirësim në normën e likuidimit të çështjeve dhe në rendimentin mesatar për gjyqtar. Përherë të parë pas disa vitesh, është shënuar një ulje e backlog-ut në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë të Tiranës, që ka mbartur ngarkesën më të madhe të çështjeve administrative në vend.

Raporti i KLGJ për vitin 2024 kërkon mbështetjen e Kuvendit në lidhje me: Miratimin e ndryshimeve ligjore të propozuara dhe të dërguara në Kuvend (i) nga grupi i punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”, të cilat synojnë uljen e ngarkesës dhe rritjen e efikasitetit, (ii) ndryshimet e propozuara ligjore në lidhje me eksperiencën minimale të nevojshme për t’u zgjedhur kryetar gjykate (iii) si edhe atyre që lidhen me rritjen e transparencës përmes publikimit të informacionit mbi statusin e gjyqtarëve, në mënyrë të plotë dhe të paanonimizuar. Mbështetje financiare për vazhdimësinë e realizimit të projekteve të investimeve në infrastrukturën e IT-së për sistemin gjyqësor, si dhe rritjen e fondeve në shpenzime kapitale (investime) në përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore, në disa gjykata të vendit (gjykata e apelit, gjykatave të shkallës së parë Fier, Tiranë, Durrës dhe Lezhë).

KLGJ ka propozuar rritjen e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit, nga 13 në 22 gjyqtarë, si dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë nga 408 në 417 gjyqtarë. Sa i përket rritjes së numrit të ndihmësve ligjorë në kuadër të plotësimit të vakancave aktuale, 6 ndihmës ligjorë janë pranuar në shërbimin civil gjyqësor në muajin tetor të vitit 2024.

Gjatë vitit 2024, kanë ushtruar efektivisht funksionin e gjyqtarit në gjykatat e të gjitha niveleve, gjithsej 272 gjyqtarë në të njëjtën periudhë kohore. Kjo nënkupton se sistemi gjyqësor gjatë vitit 2024 ka funksionuar me pothuajse 66.6% të kapacitetit të tij, 6.6% më shumë se në vitin 2023. Gjatë vitit 2024, janë emëruar 32 magjistratë.

Numri i vakancave në sistem për gjyqtarë është 136 vakanca (nga të cilat 75 të përhershme dhe 61 vakanca të përkohshme).

Janë trajtuar 49 kërkesa për të drejtën e informimit, informacion i cili është i pasqyruar në faqen zyrtare të KLGJ.

Rekomandime

Një rritje e qëndrueshme e fondeve buxhetore në shpenzime kapitale (investime) në vitet në vijim është esenciale për përmbushjen e objektivave për përmirësimin infrastrukturor të gjykatave, me ndikim të rëndësishëm në funksionimin efikas të sistemit gjyqësor.

Ashtu si në projektin e hartës së re gjyqësore edhe në rastin e Strategjisë Kombëtare për uljen e stokut të çështjeve të prapambetura në gjykata, projekti nuk është shoqëruar me një paketë financiare të nevojshme për të mbështetur objektivat e strategjisë. KLGJ duhet ta shoqërojë edhe strategjinë e uljes së stokut me impaktin konkret financiar të zbatimit të panit të veprimit.

KL Gj duhet edhe gjykatat duhet të forcojnë instrumentet e lobimit si dhe të shfrytëzojnë hapësirat ligjore për të diskutuar e kërkuar në Kuvend plotësimin e nevojave për investime nga qeveria duke shmangur edhe vendime të administratës që bllokojnë fondin për investime në gjyqësor. Ndërsa ka pasur zhvillime shumë pozitive në këtë drejtim në fillim të vitit 2025, KLGJ duhet të këmbëngulë dhe avokojë për ndërtesa të reja për gjykatën e Fierit, Gjykatën e shkallës së parë të JP të Tiranës, Lezhës por edhe Kukësit si dhe një zgjidhje afatgjatë për gjykatën e Apelit të JP.

Ndryshimet e shpeshta në buxhet rritin ndërveprimin me institucionet qeveritare si ministria e Financave, çfarë mund të sjellë vonesa në alokimin e fondeve. Vonesat mund të prodhojnë edhe presion apo tension ndërinstitucional.

KL Gj duhet të adresojë shumë shpejt, edhe përmes akteve të vjetra, emërimin e kryetarëve të gjykatave.

KL Gj duhet të shmangë diferencat në trajtim mes administratës jogjyqësore në gjykata të kategorive të ndryshme. Duhet të bashkëpunojë me KLP dhe ministrinë e Financave e më tej edhe Kuvendin për kuptimin e drejtë të pagesave të orëve jashtë orarit, duke unifikuar një rregullore për të gjithë magjistratët në sistem, e dakordësuar dhe e pranuar edhe ministria e Financave dhe komisioni përgjegjës në Kuvend.

Bibliografia

Legjislacioni, Akte Ligjore dhe Dokumente Strategjike

- Ligji nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 96/2016”
- Ligji nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar si Ligji për Vettingun)
- Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitin 2023”, i ndryshuar
- Ligji nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (referuar si Ligji për Organizimin);
- Ligji nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”
- Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, i ndryshuar (referuar si Ligji për Statusin)
- Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”
- Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar
- Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar
- Raport përfundimtar i KLSH “Mbi auditimin tematik të përputhshmërisë, të ushtruar në bazë të autorizimit për verifikimin e përllogaritjes së pagave, me fokus të veçantë ndër të tjera vjetërsinë në punë, si dhe kuadrin ligjor e rregullator mbi të cilin mbështetet përllogaritja e tyre në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, janar 2021
- Rezolutë e Kuvendit "Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2021"
- Rezolutë e Kuvendit "Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022"
- Rezolutë e Kuvendit "Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023"
- Rregullorja e Kuvendit, neni a/1, 102, 103
- Udhëzimi i KLGJ nr.78 datë 16.02.2023 “Për llogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar)”
- Udhëzimi nr.14 datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësite e Qeverisjes Qendrore”
- Udhëzimi nr.22 date 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të NJQQ”
- Urdhër i KLGJ nr.17, datë 26.02.2024 “Për miratimin e regjistratit të riskut të brendshëm në Këshillin e Lartë Gjyqësor, 2024”
- Urdhër nr.42, datë 20.07.2023, të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor “Ngritja e grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë”
- Udhëzimi i KLGJ nr.48, datë 08.02.2022 “Për mënyrën dhe procedurën e kompensimit për orët shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, nga nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë të administratës gjyqësore”
- Udhëzimi i KLGJ Nr. 559, datë 29.12.2022 “Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të gjyqtarit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”.
- Udhëzimi Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
- Vendimin nr. 34, datë 10.4.2017 (V-34/17), të Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 35, datë 22.11.2022, i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim i KLGJ nr. 147, datë 29.03.2023, “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”
- Vendimi i KLGJ Nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”
- Vendimi i KLGJ nr. 454, datë 02.11.2022 mbi “Planin e Komunikimit për Gjykatat”
- Vendim i KLGJ nr. 592 dhe 593, datë 09.10.2024; nr. 483, datë 31.07.2024; nr. 588, datë 09.10.2024; nr.591, datë 09.10.2024; nr. 282 dhe nr. 283, datë 29.05.2024. nr. 585, datë 09.10.2024
- Vendim i KLGJ, nr.641, datë 23.12.2020, “Mbi propozimin për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre”
- Vendim i KLGJ nr. 661, datë 02.11.2023 “Për përllogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar), për periudhën 1 janar 2019 deri më 08 janar 2023”.

Bibliografia

- Vendim i KLGJ nr. 741, datë 26.12.2023 “Për detajimin e fondeve buxhetore shtesë në shpenzime korrente, në buxhetin e vitit 2023, për sistemin gjyqësor”
- Vendim i KLGJ nr. 743, datë 28.12.2023 “Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për sistemin gjyqësor”
- Vendimi i Kuvendit nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”
- Vendimi nr. 38 datë 28.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për pagesën e Gjyqtarëve më ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare”, i ndryshuar me Vendimin Nr.674, datë 08.11.2023 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr.38, datë 28.02.2019”.
- VKM nr.113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale”
- VKM nr.421, datë 26.06.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin Nr.325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesa të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike,” të ndryshuar, Ndryshimit të tatimit mbi të ardhurat ne muaji Maj 2023 sipas legjislacionit në fuqi
- VKM nr. 422, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në Vendimin 326 date 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione në Administratës publike” të ndryshuar , kthim përgjigja e Ministrise se Financave për shtesat e vështirësisë në punë të punonjësve mbështetës
- VKM-ja nr. 548, datë 27.7.2016, “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”

Analizë dokumentesh për institucionin e monitoruar

- Pika 4.3 e Kapitullit IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016
- Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbajtur, më 24.08.2023
- Raport auditimi i KLSH në Gjykatën e lartë, auditim financiar dhe përputhshmërie, 23.02.2023
- Raporti vjetor i KLGJ, 2021
- Raporti vjetor i KLGJ, 2022
- Raporti vjetor i KLGJ, 2023
- Raporti vjetor i KLGJ, 2024

- Raporti vjetor i komisionit të buxhetit dhe administrimit
- Raporti i monitorimeve për periudhën janar – dhjetor 2024
- Raporti i monitorimeve për periudhën janar – dhjetor 2023
- Raporti i monitorimeve për periudhën janar – dhjetor 2022
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, 2024
- Raporti i veprimtarisë të auditimit të brendshëm, për vitin 2024, KLGJ

Intervistë me drejtues institucionesh

- Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Buxhetit dhe Financës, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), 04.07.2025

Burime online

- <https://shqiptarja.com/lajm/prbuxheti-2024-klg-e-pakenaqur-duhen-para-per-rikonstrukcionin-dhe-ndertimin-e-gjykatave-kpa-kerkon-rritje-pagash>
- <https://www.coe.int/en/web/cepej/-/dashboard-cestern-balkans-publication-of-the-results-of-the-fourth-cycle-of-data-collection>
- <https://rm.coe.int/dashboard-cestern-balkans-questionnaire-2023-20231010-rev1/1680ad53ae>
- <https://rm.coe.int/albania-deliverable-2/1680ad53ab>
- <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/657-vkm-nr-321-date-31-05-2023-per-miratimin-e-strukture-se-pagave-niveleve-te-pagave-dhe-shtesave-te-tjera-mbi-page-te-zevendesministrit-funksionareve-te-kabineteve-prefektit-nenprefektit-nepunesve-civile-dhe-nepunesve-ne-disa-institucione-te-administrates>